



## VENDIM

*Nr. 164, Datë 06.10.2016*

### MBI MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR VERIFIKIMIN DHE VULOSJEN E MATËSAVE ELEKTRIKË

Në mbështetje të neneve 16 dhe 77 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, Ligjit Nr.9875, datë 14/02/2008 “Për Metrologjinë” i ndryshuar dhe Kodit të Matjes i ndryshuar, nenit 26 “Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr 96 datë 17.06.2016 Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.10.2016, mbasi shqyrtoi draftin e kontratës Tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë teknike të ERE,

#### **Konstatohet se :**

- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë me shkresën protokolluar në ERE nr. 581/8 në datën 28.09.2016, ka depozituar propozimin për miratimin e kontratës Tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë.
- Per qellime të konsultimit mbi përmbajtjen e Draftit, pas botimit në Gazetë të njoftimit për fillimin e procedurës së miratimit të Draft kontratës TIP, ERE ka kërkuar opinionin e Autoritetit të Konkurrencës, MEI, OSHEE sh.a dhe subjekteve të autorizuara nga DPM.
- ERE ka organizuar disa seanca dëgjimore me të gjitha palët e interesit me qëllim diskutimin e draft Kontratës Tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë.
- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 21699/1 Prot., datë 04.10.2016, ka shprehur dakortësinë e saj mbi këtë draft.
- ERE në bazë të nenit 77 pika 10 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ka detyrimin të miratojë kontratën Tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë Kontratën Tip për verifikimin dhe vulosjen e matësave elektrikë. (bashkelidhur Kontrata dhe 29 Anekset e saj).
2. Tarifat për verifikimin e matësave, sic shprehur në Aneksi nr.1, “Mbi listën e çmimeve tavan njësi”, në zbatim nenit 77 pika 8 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Financave.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**